

Guidë

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE TË ZYRTARËVE QË USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE NË ADMINISTRATËN
DOGANORE

*Kjo Guidë shërben për një njohje më të mirë me
ligjin dhe me përgjegjësitë tuaja.*

Çfarë është një konflikt interesi?

“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit

- ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave.

Konflikti i interesit mund të jetë rast pas rasti ose i vazhdueshëm

“Konflikt rast për rast i interesit” është

- gjendja me konflikt interesi,
- në njërën nga tri llojet (*faktik, / mundshëm, në dukje*),
- që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimarrje të vecantë

Interesat private përfshijnë:

- ⇒ Të drejtat dhe detyrimet pasurore të çdo lloj natyre
- ⇒ Çdo marrëdhënie tjeter juridiko-civile Dhurata, premtime, favore dhe trajtime preferenciale
- ⇒ Negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit Angazhime në veprimtari private
- ⇒ Marrëdhënie familjare, të bashkëjetesës, të komunitetit, etnike.

“Konflikti i vazhdueshëm i interesave”

- ⇒ Është gjendja, në të cilën konflikti i interesit (*i mundshëm apo në dukje*), mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

Llojet e interesave që bëhen shkak për konflikt të vazhdueshëm

- ⇒ Interesa pasurore
 - Pronësi mbi aksione apo pjesë në kapital
- ⇒ Veprimtari private
 - Tregtare apo profesione të lira
- ⇒ Rol drejtues
 - në organizata fitimprurëse apo jo
- ⇒ Punësim i dytë
 - me kohë të plotë

Kush përfshihet:

🇲🇰 Çdo zyrtar i administratës doganore:

- nëpunës i nivelit të lartë
- nëpunës i nivelit të mesëm apo
- specialist që kanë kompetenca vendimmarrëse nga procesi paraprak deri në përmbajtjen përfundimtare të aktit.

🇲🇰 Personat e lidhur :

- bashkëshorti/ja
- bashkëjetuesi/ja
- fëmijët madhorë
- prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es

Ç'duhet të bëjë zyrtari:

- Të vlerësojë nëse ka mundësi që interesat e tij mund të bëhen faktor për rënien qoftë edhe në konflikt në dukje të interesit.
- Nëse mundësia e rënies në konflikt interesi ekziston, zyrtari:
 - Është i detyruar të bëjë vetdeklarim, rast për rast, kur përpara një vendimarrjeje publike, ai është në konflikt me interesat e tij private si dhe të personave të lidhur.

- Vlerëson se cila do të ishte zgjidhja parandaluese më e mirë
- Kërkon mendimin e eprorit
- Merr vendim vetë ose zbaton vendimin e eprorit
- Kujdeset që gjithçka të jetë e dokumentuar sa më mirë.

Çfarë duhet të bëjë eprori:


- Të shqyrtojë me objektivitet rastin e paraqitur nga një zyrtar dhe të marrë vendimin e duhur e ta dokumentojë atë.
- Të jetë sa më aktiv duke shfrytëzuar burimet e mundshme e të ligjshme
- Kur krijon dyshim të arsyeshëm t'ij kërkojë zyrtarit informacion mbi interesat e tij, t'ij verifikojë, analizojë ato dhe të marrë vendimin e duhur.
- Të dokumentojë rastin

Kufizimet për zyrtarin e organit doganor:

- ✚ Kufizimet për zyrtarin e organit doganor, janë përcaktuar në nenet 31 dhe 32 të ligjit nr.9367 datë 7.4.2005, i ndyshuar.

Zyrtarët e organit doganor:

- nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse;
- nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse kur këto ushtrojnë veprimtari brenda kompetencës dhe juridiksionit të zyrtarit;
- nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizik tregtar të çdo forme, profesione të lira ...;
- mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare,;
- nuk mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që kryejnë veprimtari import-eksporti.

 Zyrtarët e administratës doganore të cilët i nënshtrohen kufizimeve të nenit 32 të ligjit, nr.9367 datë 7.4.2005, i ndyshuar, të përcaktuar me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm janë :

- a) Drejtori dhe Zv.drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- b) Këshilltarët
- c) Drejtorët e Drejtorive në D.P. të Doganave;
- d) Në Degët Doganore:
 - Kryetari
 - Përgjegjësi sektorit
 - Përgjegjësi Zyrës/Turnit
 - Doganieri

Sanksionet:

Llojet e sanksioneve

- Kundërvajtje administrative, gjobë nga 30.000 deri 500.000 lekë
- Masa disiplinore
- Kundërvajtje penale, dënim me gjobë ose burgim, sipas dispozitës 257/a të Kodit Penal.

Raste tipike të konfliktit të interesave për zyrtarët e administratës doganore:

Rasti 1

Zyrtari A.N. është doganier i kategorisë C1 në Zyrën Doganore. Prindërit e tij kanë aksione në shoqërinë "Dajti" Sha e cila ushton veprimtari Import . Eksporti. Bazuar në nenin 32 të ligjit zyrtari A.N. është në konflikt të vazhdueshëm të interesave.

Mënyra e zgjidhjes:

Prindërit e zyrtarit veprojnë si vijon:

- shesin pjesën e aksioneve që zotërojnë në shoqërinë "Dajti" sha
- transferojnë aksionet tek një i besuar
Vetë zyrtari vepron si vijon:
- Nga organi i emërtesës kalon në një funksion tjetër të administratës doganore, në të cilën nuk rezulton në konflikt të vazhdueshëm të interesave
- Largohet nga administrata doganore.

Rasti 2

Zyrtari D.L. është doganier C2 në zyrën doganore X. Gjatë orarit të punës paraqitet shoqëria tregtare "Vjosa" sha në të cilën është aksioner vëllai i doganierit D.L. Bazuar në pikën 1 shkronja %b+të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative zyrtari D.L. është në konflikt rast për rast të interesave.

Si duhet të veprojë zyrtari:

- ⇒ Plotëson formularin për deklarimin rast për rast të interesave
- ⇒ Ja dorëzon eprorit direkt dhe pret përgjigjen e tij.

Mënyra e zgjidhjes:

Nuk merr pjesë në rastin e zhdoganimit të shoqërisë %josa+sha

Ligje në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave në administratën doganore

- **Ligji nr.9367 datë 7.4.2005**
“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- **Ligji nr.8449 datë 27.1.1999**
“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- **Ligji nr.9131 datë 8.9.2003**
“Për rregullat e etikës në administratën publike”

Ju mund të merrni informacion edhe nëpërmjet faqes së internetit : www.hidaa.gov.al